



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.7/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti - kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.12.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, ZP.Anr.7/2025 e datës 09.12.2025, me të cilën ka kërkuar që të obligoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të anuloj vendimin me nr. Protokolli 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të miratoj vendimin për miratimin e përbërjes së Këshillave të vendvotimit në qendrat e votimit të rregullta dhe me kusht, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 për Komisionet e Votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 09.12.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën pretendojnë se me 8.10.2025, KQZ ka miratuar vendimin nr. 01/3693-2025 për miratimin e rekomandimit për përbërjen e Këshillave të Vendvotimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht. Subjekti politik Srpska Lista nuk është njoftuar zyrtarisht për këtë vendim, gjë që është një rast unik që kur ky subjekt merr pjesë në zgjedhje. Theksojnë se pas insistimit, vendimi i është dorëzuar në orën 21:00. Subjekti politik Srpska Lista konsideron se KQZ, me miratimin e vendimit nr. 01/3693-2025, ka shkelur Rregulloren Zgjedhore nr. 11/2024, pikërisht nenin 3, paragrafin 2, i cili thotë: "KQZ kujdeset për të siguruar përfaqësim të drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, në bazë të numrit të ndryshëm të popullsisë brenda komunës dhe numrit të votave të subjekteve politike të çdo

komuniteti, në nivel vendi dhe në nivel komune. Tutje theksojnë se përbërja e këtyre këshillave është jolegjitime dhe në kundërshtim me ligjin, dhe se disa subjekte politike janë favorizuar, ndërsa subjekti politik Srpska Lista është diskriminuar, sepse i është caktuar një numër shumë më i vogël kryetarësh, anëtarësh dhe anëtarësh rezervë. KQZ-ja, në përputhje me ligjin, ishte e detyruar t'ia caktonte subjektit politik që ka fituar numrin më të madh të votave të komunitetit serb në komunat e listuara më poshtë: Në komunën e Novobërdës, Srpska Lista nga 23 vendvotime ka vetëm 3 kryetarë të këshillit të vendvotimit, dhe në 3 vendvotime nuk ka asnjë anëtar, ndërkohë që në zgjedhjet lokale Srpska Lista ka fituar mbi 61.39% të votave. Në këtë komunë, nga 6 kryetarë secila kanë Vetëvendosja me 8.76% të votave, PDK me 1.87% dhe LDK me 19.66% të votave. 2 kryetarë ka marrë GI "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak", edhe pse ata nuk kanë fituar asnjë votë. Në komunën e Leposaviqit, nga 25 vendvotime, Srpska Lista ka kryetarë në vetëm 7, ndërkohë që në zgjedhjet lokale kemi fituar 75.1% të votave. Në këtë komunë, të njëjtin numër kryetarësh kanë Vetëvendosja me 1.56% të votave, PDK me 2.14% të votave, ndërsa "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak" me 4.92% të votave ka 4 kryetarë, edhe pse kanë 15 herë më pak vota se Srpska Lista. Në komunën e Shtërpçës, Srpska Lista ka kryetarë në 2 nga 17 vendvotime, ndërkohë që në zgjedhjet lokale kemi fituar 62.02% të votave. Në të njëjtën komunë, Vetëvendosja ka 4 kryetarë, ndërkohë që në zgjedhjet lokale ka fituar 3.93% të votave, pra gati 15 herë më pak se Srpska Lista. PDK me 8.14% ka 4, dhe LDK me 7.19% të votave të fituara ka 3 kryetarë, ndërkohë që AAK, pa asnjë votë, ka të njëjtin numër kryetarësh si ne. Me ne është barazuar edhe subjekti politik "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak" i cili në zgjedhjet lokale ka fituar 7.44% të votave, pra gati 6 herë më pak se Srpska Lista. Në komunën e Zubin Potokut, nga 15 vendvotime, Srpska Lista ka kryetarë në 3 nga 15 vendvotime, ndërkohë që në zgjedhjet lokale kemi fituar 75.12% të votave. Nga ana tjetër, Vetëvendosja me 5.61%, PDK me 5.05%, LDK me 1% dhe GI "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak" me 3.3% (ose 23 herë më pak vota të fituara) kanë të njëjtin numër kryetarësh. Në komunën e Zveçanit, nga 11 vendvotime, Srpska Lista ka vetëm 2 kryetarë, ndërkohë që në zgjedhjet lokale ka 86.77% të votave. Të njëjtin numër kryetarësh ka LDK, e cila nuk ka fituar asnjë votë në këtë komunë. Ndërkohë, Vetëvendosja me 2.4% të votave të fituara dhe PDK me 3.37% të votave të fituara kanë nga 3 kryetarë secila. Në një vendvotim, Srpska Lista nuk ka asnjë anëtar. Në komunën e Parteshit, nga 7 vendvotime, kemi vetëm 3 kryetarë, ndërkohë që në zgjedhjet lokale kemi fituar 96.14% të votave. Më shumë se ne, përkatësisht 4 kryetarë, ka GI SPO, e cila në zgjedhjet lokale nuk ka fituar asnjë votë në këtë komunë. Në komunën e Ranillugut, Srpska Lista ka 3 kryetarë nga numri i përgjithshëm i vendvotimeve. Në këtë komunë kemi fituar 81.49% të votave. Të njëjtin numër kryetarësh ka GI SPO, edhe pse kanë pasur 8 herë më pak vota se ne. Një mospërputhje edhe më e madhe është se 2 kryetarë ka Vetëvendosja, dhe nga 1 kryetar kanë LDK dhe PDK, ndërsa asnjë nga këto parti nuk ka fituar asnjë votë në zgjedhjet lokale. Në komunën e Mitrovicës Veriore, nga 22 vendvotime, kemi kryetarë në vetëm 4 vendvotime, ndërkohë që në zgjedhjet lokale kemi fituar 62.36% të votave. Numri i kryetarëve në këtë komunë i caktuar Vetëvendosjes, e cila në zgjedhjet lokale ka fituar 8% të votave, është 5. Ndërsa PDK me 4.24% të votave dhe LDK me 0.6% të votave të fituara në zgjedhjet lokale kanë marrë nga 5 kryetar secila. Në komunën e Graçanicës, nga 34 vendvotime, Srpska Lista ka

vetëm 6 kryetarë, dhe në 3 vendvotime nuk kemi as kryetar as anëtar, edhe pse në zgjedhjet lokale kemi fituar 63.92% të votave në këtë komunë, përkatësisht 7000 vota, ndërsa të gjitha partitë e tjera shqiptare me 23% (ose gati tre herë më pak vota) kanë marrë 22 kryetarë, pra gati 4 herë më shumë se Srpska Lista. Të njëjtin numër kryetarësh dhe anëtarësh si Srpska Lista ka GI SPO, e cila ka fituar 6 herë e gjysmë më pak vota. Në komunën e Kllkotit-Verbocit, nga 8 vendvotime, Srpska Lista ka vetëm 1 kryetar nga 8 vendvotime, ndërkohë që në zgjedhjet lokale kemi fituar 40.47% të votave. Ndërsa më shumë, nga 2 kryetarë secila, kanë LDK me 9.99% të votave të fituara, PDK me 8.04% dhe Vetëvendosja me 7.32% të votave të fituara. Srpska Lista nuk ka asnjë kryetar në 28 komunat me shumicë shqiptare. As edhe në komunën e Obiliqit ku kemi dy anëtar të kuvendit, Fushë Kosovës, Gjilanit, Vushtrrisë dhe Kamenicës ku kemi fituar nga 1 anëtar të kuvendit secila. Tutje, theksojnë se kur bëhet fjalë për votimin me kusht, nga 38 komunat në Kosovë, dhe ato komunat me shumicë serbe, Srpska Lista ka vetëm 3 kryetarë, dhe atë në komunat e Novobërdës, Graçanicës dhe Parteshit dhe se nuk kanë asnjë anëtar në vendvotimet për votim me kusht në komunat me shumicë shqiptare dhe se vendime të tilla të paligjshme për përbërjen e këshillave të vendvotimit janë marrë edhe për zgjedhjet parlamentare të mëparshme të mbajtura më 9 shkurt 2025 dhe për zgjedhjet lokale më 12 tetor, ashtu që kanë propozuar që PZAP të miratojë një vendim me të cilin do të anulohet fuqinë ligjore të vendimit të paligjshëm dhe jo kushtetues të Komisionit Qendror Zgjedhor, në përputhje me nenin 53 paragrafi 1, nenin 131 paragrafi 4, dhe nenin 132 paragrafi 5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në përgjigje në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thekson se bazuar në Ligji nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka emëruar “Përbërjen e Këshillit të Vendvotimit (KVV). Kriteret të cilat janë marrë në përcaktimin e përbërjes së këtij trupi menaxhues zgjedhor është e bazuar në Rregulloren Zgjedhore nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve kriteret si vijon: Subjektet politike të certifikuara, të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale, kanë të drejtë të nominojnë nga një (1) anëtar në KVV. Po ashtu, përfaqësim edhe subjekteve politike të reja të certifikuara për zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sipas nevojës, mund ta rrisë ose ta zvogëlojë numrin e anëtarëve të KVV-së deri në dy (2) anëtarë në KVV, ku KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ). Tek përfaqësimi i komuniteteve në KVV, përcakton numrin e dallueshëm të popullsisë brenda komunave; Numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet në nivel vendi dhe në nivel komunal. KQZ ka vazhduar duke marrë për bazë edhe kriteret tjera shtesë: KQZ, në bazë të formulës përkatëse, përfshin edhe subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, duke u bazuar në përqindjen e votave të fituara, nëse nuk arrihet të plotësohet numri prej pesë (5) anëtarësh në KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të certifikuara për zgjedhjet e parakohshme (28 Dhjetorit), KKZ ka të drejtë t’i rekomandojë KQZ-së për nominimin e personave me përvojë në proceset zgjedhore, në rast se numri i anëtarëve të KVV-së nuk plotësohet.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit operacional dhe garantimit të një procesi zgjedhor të rregullt dhe të besueshëm përbërja e një Këshilli të Vendvotimit (KVV) bazohet në strukturën standarde dhe orientuese prej pesë (5) anëtarëve. Me përjashtim të pesë (5) komunave Deçan, Gllogoc, Kaçanik Junik dhe Hani i Elezit ku numër i përfaqësimit në këtë mekanizëm zgjedhor është katër (4), ndërsa vetëm në komunën e Prizrenit për shkak të numrit të madh të komuniteteve KQZ ka paraparë rritjen prej gjashtë (6) anëtarë në Këshillat e Vendvotimit.

Në rastin konkret, komuniteti pakicë në Republikën e Kosovës me numrin më të madh të anëtarëve dhe me përfaqësimin më të gjerë në Këshillat e Vendvotimeve (KVV) është komuniteti serb. Subjekti politik më i madh nga komunitetet jo-shumicë, i përfaqësuar në këtë trup zgjedhor, është Srpska Lista. Duke u bazuar në këto elemente, dhe duke marrë parasysh faktin se katër (4) subjektet politike parlamentare të komunitetit shumicë (shqiptar) e kanë kaluar pragun zgjedhor, këtyre subjekteve u takon përfshirja në të gjitha KVV-të. Në këtë kuadër, subjekti me radhë me përfaqësimin më të madh nga komunitetet jo-shumicë është Srpska Lista. Komuniteti serb është i përfaqësuar në 23 komuna përmes tre (3) subjekteve politike: Srpska Lista, Za Slobodu Pravdu i Opstanak, dhe Kosovski Savez, ku përfaqësimi sipas subjekteve është si vijon Srpska Lista është e përfaqësuar në 23 komuna me: 34 kryesues, 197 anëtarë dhe 25 rezerva, gjithsej 256 anëtarë, Za Slobodu Pravdu i Opstanak është e përfaqësuar në 23 komuna me: 29 kryesues, 189 anëtarë dhe 23 rezerva, gjithsej 241 anëtarë, Kosovski Savez është i përfaqësuar me: 28 anëtarë dhe 3 rezerva, gjithsej 31 anëtarë. Në total, nga komuniteti serb në Këshillat e Vendvotimeve janë: 63 kryesues, 386 anëtarë dhe 61 rezerva, që së bashku përbëjnë 528 anëtarë. Sa i përket vendvotimeve me kusht, situata paraqitet në të njëjtën linjë të përfaqësimit proporcional.

Për rrjedhojë, pretendimet për diskriminim të komunitetit serb nuk qëndrojnë, pasi ata përbëjnë komunitetin me numrin më të madh të përfaqësuesve në KVV, si dhe komunitetin me pjesëmarrjen më të lartë në ekipet e numërimit në Qendrën e Komunale të Numërimit (QKN). Parimi i barazisë, sipas legjislacionit në fuqi, zbatohet për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, përfshirë komunitetin shumicë dhe komunitetet jo-shumicë. Kjo përbërje reflekton praktikën më të mirë për menaxhimin e një vendvotimi si dhe e njëjta vlen edhe të ekipet e numërimit në QKN që siguron ndarje të qartë të përgjegjësisë, transparencë dhe rrjedhë të qetë të procesit zgjedhor. Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr. 1-3693-01-2025, i datës 08.12.2025, për miratimin e formulës për përbërjen e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve për vendvotimet e rregullta, me kusht dhe rezervë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të parapara të mbahen më 28.12.2025, do t'u dërgohet të gjitha subjekteve politike të certifikuara më 09.12.2025, duke përfshirë edhe Listën Serbe. Dërgimi në këtë afat kohor bëhet për shkak se procesi i ndarjes dhe finalizimit të vendvotimeve është ende në zhvillim dhe përbën fazë të domosdoshme teknike për zbatimin e këtij vendimi. Ky proces është gjithashtu i ndërlidhur me procedurat e votimit jashtë Kosovës, çka kërkon harmonizim të të gjitha afateve dhe veprimeve administrative për të garantuar zbatimin e rregullt dhe ligjor të planit të aktiviteteve zgjedhore.

Pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë për arsyet e lartë cekura dhe kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që duke marrë parasysh faktet dhe argumentet e paraqitura, të refuzojë ankesën si të pabazuar. Si dëshmi kanë bashkangjitur listën me anëtarët e KVV-ve, Ekipeve të Numërimit në QKN miratuar nga KQZ dhe Vendimin si dhe tabelën e përfaqësimit të komuniteti serb në këto dy mekanizma.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, vëren se ankesa është e pabazuar.

Sipas vlerësimit të Panelit pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se vendimi i KQZ-së, me nr. protokolli 01/3693/2025, të datës 08.12.2025, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, lidhur me mos emërimin e drejtë të anëtarëve të tyre nga radhët e subjektit politik Lista Serbe janë të pabazuara.

Me nenin 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228, përcaktohet se *”Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin kryesuesit dhe anëtarëve të vendvotimit, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të paraqesin ankesë në PZAP, brenda 48 orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ.”* Po ashtu me nenin 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohet *”Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë”*. Ndërsa paragrafi 4, i po të njëjtit nen parasheh që *”Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve, të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni”*.

Po ashtu edhe me nenin 20 paragrafi 1 i Rregullores Zgjedhore nr.16/2024, për Qendrat Komunale të Numërimit, përcaktohet se *”KQZ, me vendim, përcakton numrin e ekipeve të numërimit dhe numrin e anëtarëve brenda ekipeve të numërimit, sipas specifikave të komunave përkatëse”*. Paragrafi 2 i Rregullores përcaktohet se *”Kryesuesit e ekipeve të numërimit, zgjedhën në mënyrë të barabartë nga katër subjektet e para që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë dhe janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet aktuale”*. Ndërsa paragrafi 4 i kësaj rregullore përcakton se *”Procedura e nominimit dhe emërimit të ekipeve të numërimit bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve”*.

Ndërsa në nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve përcaktohet se *”KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në: 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune; 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal”*.

Andaj bazuar në dispozitat e sipërcituara ligjore Paneli ka gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ, nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga nenin 65 dhe 64 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenit 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve.

Kjo për faktin se me rastin e përcaktimit të numrit për përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, ka zbatuar në tërësi dispozitat ligjore në fuqi duke marrë parasysh rezultatet zgjedhore të fundit dhe renditjes së subjekteve politike, përfshirë edhe subjektin politik ankues. Kjo pasi që subjektit politik Lista Serbe i është dhënë përfaqësim nga ana e KQZ në 23 Komuna me gjithsej 256 anëtarë në Këshillat e Votimit, prej tyre 34 kryesues, 197 anëtar dhe 25 rezervë.

Mbi këtë bazë Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të sipërcituara, pasi që subjekti politik Lista Serbe është i përfaqësuar në KVV në pajtim me këto dispozita dhe në bazë të Formulës për emërimin e KVV-ve, si dhe duke u bazuar në kriteret Rezultatet e Zgjedhjeve të fundit në nivel komunal dhe nacional, e po ashtu edhe të dhënat nga raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga Regjistrimi i Popullsisë 2024.

Gjithashtu nuk qëndron edhe pretendimi për diskriminimin e komunitetit serb, kjo pasi që KQZ ka vepruar drejtë lidhur me përfaqësimin e komuniteteve, pasi që përfaqësimi i komunitetit serb është i përfaqësuar në 23 komuna, me gjithsej 528 anëtarë në Këshillat e Vendvotimit, prej tyre 63 kryesues, 386 anëtarë dhe 61 rezervë, duke marrë për bazë se në nenin 3 paragrafi 1 të Rregullores 11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve ndër të tjera përcaktohet se *“...se KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV për të gjitha komunitetet duke u bazuar në numrin e dallueshëm të popullatës brenda një komune dhe numrin e votave të secilit komunitet në nivel vendi dhe në nivel komunal”*.

Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur atë se disa subjekte politike janë favorizuar, ndërsa subjekti politik Lista Serbe është diskriminuar me këtë vendim dhe se KQZ-ja ishte e detyruar ti caktonte subjektit politik që ka fituar numrin me të madh të votave të komunitetit serb në komunat e sipërcituara, Paneli vlerëson se sipas dispozitave ligjore në fuqi nuk është obligative që numri i anëtarëve në KVV, të jetë i njëjtë për subjektet politike që vijnë nga radha e komuniteteve.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë të qartë përcakton se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”*

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Po ashtu paneli vëren se për çështje të njëjtë PZAP, me vendimin ZL.nr.18/2025 të datës 10.09.2025, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar. Ankesë kjo e cila iu ka referuar zgjedhjeve lokale të datës 12 Tetor 2025. Kurse këtë vendim nuk e ka ankimuar këtu ankuesi në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendime tjera ankimore të parashtruesit të ankuesit, por nuk ka gjetur se vendimi i atakuar është përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Prandaj, nga arsyet e parashtruara më lart bazuar në nenin 117.3 dhe 119. 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZP.Anr.7/2025, datë 10.12.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.